



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 690/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Xhavit Kërçeli kandidat për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Xhavit Kërçeli kandidat për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 14:30, ka pranuar një ankesë nga Xhavit Kërçeli kandidat për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë i cili dyshon se gjatë numërimit të votave janë manipuluar votat e tij nga ana e komisionerëve të këtyre vendvotimeve. Parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këto qendra të votimit dhe në vendvotime: në Koretin 1024D -01R, 02R, 03R dhe 04R, në Kamenicë 1001D në të gjitha vendvotimet, Kamenicë 1001x në të gjitha vendvotimet, në Hogosht 1005, 1016D Bosce, 1002D Topanice në të gjitha vendvotimet, 1026D Hodonoc në vendvotimin 01R dhe 03R

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesi i ankesës nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli vlerësoi se pretendimet në ankesë nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL Anr.690/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.